Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

03.04.2023, Prishtinë,
Ref:16.02.2023\1364-2023

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Gjon Karrica kundër Paparaci

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 28 mars 2023, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Gjon Karrica kundër Paparaci lidhur me publikimin e shkrimit me titull "Të rejat e fundit për "Lugatin", i ndërrohet klinika" dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M I

Media ka publikuar një lajm me titull "Të rejat e fundit për "Lugatin", i ndërrohet klinika", me pretendimin se artikulli bie në kundërshtim me kapitujt II (raportimi i së vërtetës), IV (e drejta për t'u përgjigjur) dhe VII (privatësia) të Kodit të Mediave.

Lajmi është shkruar në gazetë online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMShK gjen se ankesa është e pabazuar. Pra, nuk miratohet.

KMShK në lidhje çështjen e privatësisë gjen se lajmi për ndërrimin e klinikës së ankuesit nuk përbën shkelje dhe nuk është ndërhyrje në privatësi.

Andaj, KMShK vendos që ankesa të mos miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës